

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PEJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **635-26-318-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	KRASNIQI SERVICE SH.P.K.
NUI	812299031
Adresa	Rruga Skenderbeu p.n
Vendi	Suhareke
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	+38349593002
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bashkim Krasniqi
Adresa elektronike	autokrasniqi@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	23.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja dhe Servisimi i automjeteve (veturave) zyrtare të SHCK-së në Komunën e Pejës

Ky është Anulimi i dytë i procedurës së prokurimit nga ana e AK.

Sipas Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0216, të datës: 04/05/2026, AK është obliguar që të RIVLERËSOJË ofertat e OE

AK me date: 18.03.2026 fillimisht ka publikuar Vendimin e AK ku ka rekomanduar për kontratë një Oe tjetër.

Ofertën tonë e ka vlerësuar si të përgjegjshme dhe na ka dërguar Letrën Standarde për Tenderuesin e pasuksesshëm, duke dhënë arësytim që tenderi nuk na është dhënë neve sepse nuk kemi çmimin më të ulët të peshuar.

Me datë: 18.03.2026 kemi kërkuar qasje në ofertën e OE të rekomanduar dhe AK në përputhje me kërkesën tonë na ka ofruar qasjen brenda afatit ligjor.

Ne kemi analizuar ofertën e OE dhe kemi vërejtur se OE i rekomanduar nuk përmbushë kërkesat e FDT-së dhe për më tepër ka intervenuar në përshkrimin e çmimeve që nënkupton se ky OE është dashur të eliminohet e jo të rekomandohet për kontratë.

AK e ka anuluar procedurën e prokurimit dhe për këtë ANULIM ne kemi bërë ankese në OSHP ku sipas Vendimit të OSHP Nr: 2026/0216 të datës: 04.05.2026, Autoriteti Kontraktues është dashur ta kthejë lenden në RIVLERËSIM.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datë: 13.05.2026 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, por AK nuk ka marr parasysh pretendimet tona dhe ne kundërshtim në kërkesat e FDT dhe Vendimin e OSHP-se nr.216/2026 e ka anuluar perseri procedurën.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK me datë: 18.03.2026 fillimisht ka publikuar Vendimin e AK ku ka rekomanduar për kontratë një OE tjetër.

Ofertën tonë e ka vlerësuar si të përgjegjshme dhe na ka dërguar Letrën Standarde për Tenderuesin e pasuksesshëm, duke dhënë arsye të tilla që tenderi nuk na është dhënë neve sepse nuk kemi çmimin më të ulët të peshuar. Pas kërkesës për RISHQYRTIM, dhe pretendimeve (gjetjeve) ankimore, Autoriteti Kontraktues e ka RIVLERSUAR Lëndën dhe e ka anuluar procedurën.

Me datë: 26.03.2026 AK ka publikuar Njoftim Vendimin e AK për ANULIM të procedurës me arsyetimin se në dokumentacionin e tenderit kanë ekzistuar gabime në paramasë dhe parallogari. Gabimet në Paramasë dhe Parallogari kanë ekzistuar por jo në

ofertën tonë.

Siq e kemi cekur në kërkesën për rishqyrtim të datë: 21.03.2026, gabimet ishin te oferta e OE të rekomanduar me datë: 18.03.2026, e jo në ofertën tonë. Anulimi i procedurës në këtë fazë bëhet për arësyet që i parasheh neni 62 i LPP-së e jo sepse ka gabuar OE i rekomanduar nga ana e AK dhe tash kur lënda kthehet në RIVLERËSIM, ndërsa Autoriteti Kontraktues kishte deklaruar se "kemi bërë gabime në paramasë".

Në këtë Vendim të AK ne jemi ANKUAR në OSHP, dhe Sipas Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0216, të datës: 04/05/2026, AK është obliguar që të RIVLERËSOJË ofertat e OE. AK e ka kryer RIVLERËSIMIN, por nuk ka bere RIVLERËSIM të ofertave në përputhje me nenin 59 të LPP-së.

Në Vendimin e fundit dhe në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eleminuar, Autoriteti Kontraktues ka cekur që ne si OE nuk kemi përmbushur dy kërkesa të FDT-së !!! Pra i njëjti Autoritet Kontraktues që na kishtë vlerësuar si të përgjegjshëm, tash pas vendimit të OSHP-së ka cekur se nuk i kemi plotësuar kërkesat që NUK ISHIN PJESË E FDT-së !!!

Në Letrën Standarde AK ka cekur se:

1. Komisioni Rivlerësues ka konstatuar se:

Operatori Ekonomik nuk ka vulosur Aneksin 1 të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme, i cili përbën kusht thelbësor dhe duhet të plotësohet dhe të dorëzohet së bashku me deklaratën e ofertës. Mosvulosja e këtij aneksi, në të cilin janë të regjistruara automjetet (veturat, automjetet dhe kamionet), nënkupton mospërputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

KJO NUK QËNDRON sepse AK nuk ka kërkuar Vulosjen e Specifikimeve Teknike, por në pikën nr.

9.1.5 te Kërkesat mbi mundësitë teknik edhe/ose profesionale, ka vendosur këtë kërkesë:

Kërkesa 5 Specifikimi teknik i detyrueshëm

Dëshmia 5 Deklarat e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K

Pra është kërkuar Dekleratë e vulosur dhe nënshkruar mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga AK.

Ne në ofertën tonë, kemi dokumentin me emer: **9.1.5.Deklerata per Specifikime Teknike pdf**

Ku kemi deklaruar se kemi **pranuar specifikimet teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K**

Të bashkangjitur keni dokumentin që është pjesë edhe e ofertës sonë.

Po ashtu në Letrën Standarde AK ka cekur se:

2. Komisioni Rivlerësues ka konstatuar se:

Po ashtu, lidhur me deklaratën për sipërfaqen rreth objektit; Operatori Ekonomik ka deklaruar se bartjen e veturave do ta kryejë vetë, mirëpo nuk ka paraqitur deklaratë të qartë për bartjen e kamionëve. Në specifikimet teknike janë të përfshira edhe automjete të rënda, përfshirë: SCANIA kamion zjarrfikës, MERCEDES kamion zjarrfikës, VOLVO kamion zjarrfikës, IVECO kamion 4x4 zjarrfikës, FORD kamion zjarrfikës (7330 cm), si dhe DENNIS kamion zjarrfikës.

Sa i përket kësaj pike, fillimisht ju informojmë se AK nuk ka kërkuar fare Deklaratë për Bartje të Veturave/Automjeteve, por keni kërkuar Deklaratë për Hapësirën. Edhe përkundër kesaj për tu përgjigjur kerkesës së DT që "**Nëse objekti kalon këtë largësi atëherë kompania fituese e tenderit bartjen e automjeteve do ta bëjnë vet kompania pa obligime nga Autoriteti Kontraktues**", ne kemi dorëzuar DEKLERATËN ku kemi konfirmuar që Bartjen e Veturave/Automjeteve do ta bëjmë ne si AK (shiko dokumentin me emer: 9.1.4.Deklerata per hapesiren pdf.

Arësytimi i juaj se nuk kemi paraqitur Deklaratë të qartë për bartjen e kamionëve, është Devijim nga kërkesa e FDT-së dhe Vlerësim jo në përputhje me kërkesat e FDT-së, sepse një gjë e tillë nuk është kërkuar dhe ne ua kemi Dorëzuar konfirmimin se transportin do ta bëjmë ne si OE.

Të bashkangjitur keni dokumentin që është pjesë edhe e ofertës sonë.

Pra Autoriteti Kontraktues qëllimisht e ka vlerësuar ofertën tonë në kundërshtim me kërkesat e FDT-së, për më tepër po mundohet që duke devijuar këto kërkesa, të na vlerësojë ne si OE i pa përgjegjshëm dhe kjo pasi që ne kemi konstatuar njëher se ky AK ka rekomanduar për kontratë një OE i cili ishte i pa përgjegjshëm dhe pasi që ne kemi fituar këtë lëndë në OSHP sipas vendimit nr. 2026/0216, të datës: 04/05/2026

Dy OE tjerë tashmë janë palë pa Interes, sepse të njëjtit nuk janë ankuar në OSHP, pas Vendimit të datës 26.03.2026 për ANULIM nga ana e AK.

Kërkojmë nga OSHP që të aprovojë ANKESËN, të detyrojë AK që të kthejë Lëndën në RIVLERËSIM, të Vlerësojë ofertën tonë vetëm në përputhje me nenin 59 të LPP-së, e mos bëjë vlerësim për kërkesat që nuk janë pjesë e FDT-së, dhe të na shpall ne fitues si OE i përgjegjshëm me çmimin më të Lirë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

AK me kete vleresim na ka demtuar si ne apsketin e konkurences po ashtu edhe ne aspektin financiar sepse ne si Oe ofertues po obligohemi qe te paguajme shpehzime

shtese ne kete procedure perfshire edhe keto te procesit ankimor.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*